



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCËS

BUXHETIT DHE MFK

DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE


INFORMACION MBI ECURINË E REALIZIMIT TË TREGUESVE KRYESORË TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE, PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2023

Në zbatim të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.84/2022 datë 21.12.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimit plotësues nr. 2 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, VKB nr. 183 datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2023 dhe PBA 2023-2025 të Bashkisë Korçë, si dhe VKB nr. 24 datë 09.02.2023 “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2022 të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2023”, po ju informojmë në lidhje me ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, për periudhën janar-qershor 2023.

Buxheti i Bashkisë Korçë për vitin 2023 është planifikuar në vlerën **2,271,851** mijë lekë dhe realizimi për periudhën janar-qershor 2023 është **768,216** mijë lekë ose **34%** dhe krahasuar me planin 6 mujor në vlerën **1,290,931** mijë lekë realizimi është **60%**. Të dhënat e realizimit të buxhetit për periudhën janar-qershor 2023, duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, jepet si më poshtë:

000/lekë

Plan 2022	Fakt 6M 2022	%	Plan 2023	Fakt 6M 2023	%
2,085,625	699,156	34%	2,271,851	768,216	34%



Realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për Bashkinë dhe Institucionet e Varësisë është 373,341 mijë lekë ose realizuar në masën 31% kundrejt planit të vitit 2023 në vlerën 1,192,786 mijë lekë. Realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të vitit 2023, duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, jepet si më poshtë:

000/lekë


Plan 2022	Fakt 6M 2022	%	Plan 2023	Fakt 6M 2023	%
1,062,056	398,055	37%	1,192,786	373,341	31%

Për periudhën janar – qershor janë shlyer 100% e detyrimeve nga detyrimet e planifikuara me VKB nr.24 datë 09.02.2023 “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2022 të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2023”.

Detajimi i buxhetit sipas llogarive ekonomike dhe Institucioneve të Varësisë, i krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 paraqitet si më poshtë:

000/lekë

Emërtimi i llogarive	PLAN 2022	FAKT 6M 2022	PLAN 2023	FAKT 6M 2023	Dif Fakt 6M 2023-2022	±% Fakt 6M 2023-2022
Shpenzime personeli 600-601	754,909	333,793	843,201	386,161	52,368	16%
Shpenzime korrente 602-609	914,934	311,084	956,251	298,505	-12,579	-4%
Shpenzime për investime 230-231	370,612	38,050	429,538	68,565	30,515	80%
Pagesa e principalit dhe interesit 166-651	45,170	16,229	42,861	14,985	-1,244	-8%
TOTAL BASHKIA+INST	2,085,625	699,156	2,271,851	768,216	69,060	10%




- Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 843,201 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 386,161 mijë lekë ose 46%. Këto shpenzime gjatë 2022 janë planifikuar në vlerën 754,909 mijë lekë dhe realizuar 333,793 mijë lekë ose 44%, pra gjatë 2023 krahasuar me periudhën janar-qershor 2022 kemi një rritje prej 16%.
- Shpenzimet korrente janë planifikuar në vlerën 956,251 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 298,505 mijë lekë ose 31%. Këto shpenzime gjatë 2022 janë planifikuar në vlerën 914,934 mijë lekë dhe realizuar 311,084 mijë lekë ose 34%, pra gjatë 2023 krahasuar me periudhën janar-qershor 2022 kemi një ulje prej 4%.
- Shpenzimet për investime janë planifikuar në vlerën 429,538 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 68,565 mijë lekë ose 16%. Këto shpenzime gjatë 2022 janë planifikuar në vlerën 370,612 mijë lekë dhe realizuar 38,050 mijë lekë ose 10%, pra gjatë 2023 krahasuar me periudhën janar-qershor 2022 kemi një rritje prej 80%.
- Shpenzimet për principalin dhe interesin janë planifikuar në vlerën 42,861 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 14,985 mijë lekë ose 35%. Këto shpenzime gjatë 2022 janë planifikuar në vlerën 45,170 mijë lekë dhe realizuar 16,229 mijë lekë ose 36%.

000/lekë

Institucionet	PLAN 2022	FAKT 6M 2022	PLAN 2023	FAKT 6M 2023	Dif Fakt 6M 2023-2022	± % Fakt 6M 2023-2022
BASHKIA	1,011,342	286,053	1,072,041	302,885	16,832	6%
NSHMAC	430,878	188,000	489,843	188,269	269	0%
NSHP	503,824	168,495	564,846	214,608	46,113	27%
QAK	87,257	34,349	87,313	37,663	3,314	10%
KLB SHSP	46,029	21,207	51,044	23,853	2,646	12%
QDZH	500	-	550	-	-	0%

QRZH	420	158	655	156	-2	-1%
SHTP E FOSHNJËS	5,375	894	5,559	783	-111	-12%
TOTAL BASHKIA +INST	2,085,625	699,156	2,271,851	768,216	69,060	10%



- Shpenzimet e Bashkisë gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 1,072,041 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 302,885 mijë lekë, ose 28%. Këto shpenzime gjatë 2022 janë planifikuar në vlerën 1,011,342 mijë lekë dhe realizuar 286,053 mijë lekë ose 28%, pra gjatë 2023 krahasuar me periudhën janar-qershor 2022 kemi një rritje prej 6%.
- Shpenzimet e NSHMAC gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 489,843 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 188,269 mijë lekë, ose 38%. Këto shpenzime gjatë 2022 janë planifikuar në vlerën 430,878 mijë lekë dhe realizuar 188,000 mijë lekë ose 44%.
- Shpenzimet e NSHP gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 564,846 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 214,608 mijë lekë, ose 38%. Këto shpenzime gjatë 2022 janë planifikuar në vlerën 503,824 mijë lekë dhe realizuar 168,495 mijë lekë ose 33%, pra gjatë 2023 krahasuar me periudhën janar-qershor 2022 kemi një rritje prej 27%.
- Shpenzimet e QAK gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 87,313 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 37,663 mijë lekë, ose 43%. Këto shpenzime gjatë 2022 janë planifikuar në vlerën 87,257 mijë lekë dhe realizuar 34,349 mijë lekë ose 39%, pra gjatë 2023 krahasuar me periudhën janar-qershor 2022 kemi një rritje prej 10%.

- Shpenzimet e KLB Shsp gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 51,044 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 23,853 mijë lekë, ose 47%. Këto shpenzime gjatë 2022 janë planifikuar në vlerën 46,029 mijë lekë dhe realizuar 21,207 mijë lekë ose 46%, pra gjatë 2023 krahasuar me periudhën janar-qershor 2022 kemi një rritje prej 12%.
- Shpenzimet e QRZH gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 655 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 156 mijë lekë, ose 24%. Këto shpenzime gjatë 2022 janë planifikuar në vlerën 420 mijë lekë dhe realizuar 158 mijë lekë ose 38%.
- Shpenzimet e Shtp e Foshnjës gjatë 2023 janë planifikuar në vlerën 5,559 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 783 mijë lekë, ose 14%. Këto shpenzime gjatë 2022 janë planifikuar në vlerën 5,375 mijë lekë dhe realizuar 894 mijë lekë ose 17%.

Bashkangjitur:

Tabela nr. 1 e realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, dhe të ardhurat e Institucioneve të Varësisë për periudhën janar-qershor 2023.

Tabela nr. 2 e realizimit të shpenzimeve nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale për periudhën janar-qershor 2023.

Tabela nr. 3 e realizimit të shpenzimeve nga transfertat e pakushtëzuar për periudhën janar-qershor 2023.

Tabela nr. 4 e realizimit të shpenzimeve nga të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore dhe sponsorizimet për periudhën janar-qershor 2023.

Tabela nr. 5 e detajimit të shpenzimeve operative (detyrime 2022) që kanë si burim financimi të ardhurat e trashëguara nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale, transfertat e pakushtëzuar, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore dhe sponsorizimet.

Tabela nr. 6 e detajimit të shpenzimeve për investime (detyrime 2022) që kanë si burim financimi të ardhurat e trashëguara nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale, transfertat e pakushtëzuar, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore dhe sponsorizimet.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCËS

BUXHETIT DHE MFK

Valbona ZIKO

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE

E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Anxhela (QERAMIXHI) DISHNICA

DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Soniel PRIFTI

KRYETARI I BASHKISË

Sotiraq FILO